



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
BASHKIA VLORË

Nr. _____ Prot.

Data ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHEKRITEREVEPËRKUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Hekur ϕ 6, Sektori i Varrezave”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

14711000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: **1,587,267** (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme për kualifikim.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2021, 2022 , 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar: $1,587,267 \times 0.4 = 634,907$ (gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e shtatë) lekë pa tvsh

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës

2.2.2 Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2021 - 2022 - 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nqs dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

*** Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3 Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës (sipas nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit ose 31,745 (tridhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzetë e pesë) Lekë Pa TVSH

2.2.4 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2024 në të gjitha adresat ku operatorët ekonomik kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël 20% e fondit limit, në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

1,587,267 x 0.2=317,453 (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë ISO 9001 sipas objektit të kësaj kontrate (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të

paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

- **ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 14001 sipas objektit të kesaj kopntrate (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .

AK rezervon mundësinë e verifikimit të certifikatave pranë DPA në Ministrinë e Financave.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Iso 14001 parashikon një sistem të menaxhimit të mjedisit sipas standarteve europiane, si në pjesët e kembimit që do të perdoren ashtu dhe në menyren e menaxhimit të shërbimit të mirembajtjes dhe riparimit të automjeteve të Autoritetit Kontraktor. Me anë të kesaj kerkese AK kerkon nga operatori ekonomik garanci në menaxhimin e mjedisit sipas standarteve nderkombetare të akredituara.

Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e vlefshme në datën e hapjes së ofertave. Nëse certifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

*Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumentave të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **1/07/2024***

